



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Istog shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	7
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	16/05/2022
Afati për aplikim	31/05/2022 - 07/06/2022
Institucioni	Komuna Istog
Departamenti	Zyra e Kryetarit
Divizioni	
Vendi i punës	Zyra e Kryetarit
Nr. i Referencës	RN00009052
Kodi	RPC0002803



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Menaxhon në mënyrë të përditshme ndërlidhjen e komunës me mediave të shkruara dhe elektronike si dhe gazetarët me të cilët punohet në baza të rregullta;
2. Përcjellë shkrimet dhe publikimet e mediave lidhur me aktivitete dhe shërbimet e komunës dhe përgatit përgjigjet, reagimet sipas nevojës;
3. Monitoron në vazhdimësi mediat e shkruara dhe elektronike dhe përgatit një përmbledhje të informatave për menaxhmentin e lartë të komunës;
4. Mban dhe përditëson një bazë të dhënash të kontakteve të mediave dhe krijon marrëdhënie të mira me gazetarët kryesorë, veçanërisht të arsimit shkencës dhe teknologjisë;
5. Ndihmon mbikëqyrësin dhe Zyrtarin e Lartë për Komunikim me Publikun në përgatitjen e kumtesave, informatave, raporteve dhe publikimeve tjera për publikun;
6. Pranon kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, evidenton kërkesat dhe i përcjell tek burimet përkatëse të cilët duhet të përgjigjen;
7. Mirëmban, ruan dhe arkivon të gjitha kumtesat, informatat, raportet dhe publikimet tjera për publikun të komunës si dhe shkrimet e mediave të shkruara dhe elektronike për komunë;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diploma universitare, Fakulteti i gazetarisë, me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik ;
- Kualifikime të posaqme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;
- Pëvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune.



12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

